



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al
web:www.bashkiafier.gov.al

PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE I PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË FIER

**MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T
Z. EDI RAMA**

**MINISTRJA E ZHVILLIMIT URBAN
ZNJ. EGLANTINA GJERMENI**

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
ZNJ. EVIS SEMA**

**KRYETARI I BASHKISË
Z. ARMANDO SUBASHI**

Miraturar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Fier Nr. 100 Datë 06.12.2016

Miraturar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 5 Datë 29.12.2016

Hartuar nga:	Bashkia FIER
Mbështetur nga:	Projekt i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime.....	3
Lista e Figurave.....	4
Lista e Tabelave	4
Hyrje	5
1. Politika e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale	7
2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve	12
3. Kapaciteti financiar i Bashkisë Fier	14
3.1 Analiza financiare 2010-2015	14
3.1.1 Të ardhurat	14
3.1.2 Shpenzimet.....	17
3.1.3 Teprica operative neto dhe buxheti kapital	19
4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare	22
5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave	23
5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	23
5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital	25
6. Fishat e projekteve kapitale	27
7. Shtojcat	42
8. Shënime dhe referenca	50

Shkurtime

MF	Ministria e Financave
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PIK	Plani i Investimeve Kapitale
PBA	Programi i Buxhetit Afatmesëm
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
PPP	Partneritet Publik Privat
QQ	Qeveria Qendrore
TO	Teprica Operative
TON	Teprica Operative Neto
SZHT	Strategjia e Zhvillimit për Territorin
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Lista e Figurave

Figura 1. Hapat në hartimin e PIK	6
Figura 2. Financimi i investimeve kapitale	8
Figura 3. Planifikimi financiar – të krijosh hapësirë për projekte të reja	8
Figura 4. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore	14
Figura 5. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale	15
Figura 6. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre	15
Figura 7. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave	16
Figura 8. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre	17
Figura 9. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre	18
Figura 10. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve	19
Figura 11. Teprica operative neto	20
Figura 12. Të ardhura dhe shpenzime kapitale	20
Figura 13. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore	21
Figura 14. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve	24
Figura 15. Parashikimi i tepricës operative neto	25
Figura 16. Parashikime për buxhetin kapital, 2016 – 2030	26

Lista e Tabelave

Tabela 1: Inventari i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bashkinë e Fierit	13
Tabela 2: Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Fierit me shërbime vendore	13
Tabela 3: Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave	23
Tabela 4: Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve	24

Hyrje

Plani i Investimeve Kapitale (PIK) hartohet si një dokument strategjik financiar dhe adreson investimet dhe përmirësimet kapitale që rezultojnë të nevojshme për zbatimin e vendimeve të planeve të përgjithshme vendore (PPV). PIK përcakton kohën e realizimit, koston, burimet e financimit si dhe informacione të tjera të detajuara, të cilat kanë të bëjnë përgjithësisht me infrastrukturën publike. Në rregulloren e planifikimit të territorit, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015, neni 54, pika 5/b, përcaktohet se plani për zhvillimin e territorit shoqërohet edhe me planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së, i cili mes të tjerave përmban *“koston e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara të shoqëruara me planin e investimeve kapitale”*. Kjo përcakton edhe bazën ligjore kryesore, të cilës i referohet dhe respekton hartimi i PIK.

PIK është një plan shumëvjeçar i projekteve kapitale të listuara sipas prioritetit, i prezantuar në faza, që identifikon pasurinë/asetin që do të rehabilitohet, vitin kur do të fillojë të zbatohet dhe kohëzgjatjen e investimit, koston që do të kërkojë realizimi, si dhe mënyrën e propozuar të financimit të investimit. PIK prezantohet si një pasqyrë përmbledhëse që përfshin shpenzimet për investimet kapitale për çdo vit, të detajuara sipas objektivave strategjike dhe programeve që përmbushin, si dhe mënyrës së financimit të tyre.


Qëllimi kryesor i dokumentit është të mundësojë:

- garantimin e mekanizmave të nevojshëm përmes të cilëve objektivat strategjike të identifikuar në dokumentin e Strategjisë së Zhvillimit për Territorin e bashkisë të integrohen sa më mirë në procesin e planifikimit;
- krijimin e lidhjeve të drejtpërdrejta midis projekteve kapitale prioritare dhe prioritetive në kryerjen e shpenzimeve nëpërmjet shpërndarjes efektive të burimeve në dispozicion;
- parashikim më të mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë disa vjeçare për të gjitha programet e shpenzimeve;
- përdorimin e parimit të vlerës së parësë nëpërmjet efektivitetit dhe efikasitetit ekonomike në kryerjen e shpenzimeve publike;
- forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal, në linjë me programin buxhetor afatmesëm (PBA).

Hapi i parë për përgatitjen e PIK është hartimi i politikave të PIK, të cilat reflektojnë vizionin strategjik të zhvillimit të bashkisë si dhe strategjinë financiare dhe fiskale që do të ndiqet për të mundësuar realizimin e objektivave strategjike që zbërthejnë këtë vizion. Hartimi i politikës së PIK pasohet prej vlerësimit dhe identifikimit të nevojave kapitale (Figura 1. Hapat në hartimin e PIK). Hapi i tretë mundëson analizimin e kapaciteteve financiare të bashkisë, dhe prezanton një pamje të plotë të situatës dhe mundësive financiare të njësisë vendore, duke u ndalur veçanërisht në kapacitetin huamarrës të njësisë si dhe mundësinë për të reduktuar shpenzimet operative, e prezantuar instrumente të reja financiare në funksion të përmirësimit të infrastrukturave publike. Kjo analizë pasohet prej listës së projekteve kapitale të prioritarizuara, mbi bazën e një metodologjie vlerësimi të ndarë e dakordësuar me

aktorët. Mobilizimi i të ardhurave dhe fazimi i investimeve sipas nevojave dhe mundësive janë hapat që përmbyllin hartimin e dokumentit, i cili i nënshtrohet seancave të diskutimit me publikun njëjloj si PPV.

Figura 1. Hapat në hartimin e PIK



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Dokumenti i PIK për Bashkinë Fier, është i organizuar në kapituj që reflektojnë hapat e ndërmarra gjatë hartimit të PIK, dhe përmbyllet me pasqyrën përmbljedhëse të shpenzimeve për investimet kapitale sipas fazave të përcaktuara edhe në PPV. Për të gjithë periudhën e konsideruar në PIK, 2016 – 2030, shpenzimet parashikohen dhe prezantohen në tabelë të detajuara për çdo vit. Pjesë e dokumentit të PIK janë edhe fishat e projekteve kapitale, të cilat sjellin një informacion të përmbljedhur në lidhje me investimin e parashikuar, vlerën e tij, kohëzgjatjen, mënyrën e financimit, etj.

1. Politika e hartimit të Planit të Investimeve Kapitale

Politika e hartimit të PIK adreson qasjet e ndjekura në lidhje me një sërë çështjesh, si p.sh.: (i) lloji i projekteve kapitale të përfshira; (ii) periudhën kohore që PIK mbulon; (iii) mënyrën e financimit të projekteve kapitale, apo mundësinë për të mobilizuar të ardhura; (iv) strategjinë financiare dhe atë fiskale që do të ndjekë bashkia për të mundësuar realizimin e investimeve të parashikuara; (v) procesin e përfshirjes dhe konsultimit të publikut gjatë hartimit të PIK, etj.


Në këtë dokument PIK prezantohet si një prej instrumenteve që mundësojnë zbatimin e PPV-së. Ky fakt kushtëzon dhe orienton njëkohësisht hartimin e tij. Kështu, identifikimi dhe përcaktimi i nevojave për investime kapitale në bashki, bëhet drejtpërdrejtë gjatë dhe nëpërmjet procesit të hartimit të PPV-së. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procesin e prioritarizimit të investimeve kapitale, si dhe fazimin e tyre. PIK mbulon periudhën kohore 2016 – 2030 dhe investimet kapitale organizohen sipas tre fazave, të cilat reflektojnë edhe planin e veprimit të hartuar në SZHT të Bashkisë së Fierit. Për fazën e parë të PIK (2016 – 2020) jepen të detajuara në analizë të gjitha të dhënat financiare dhe fiskale si dhe mundësitë e financimit të PIK, ndërsa për fazën e dytë (2020 – 2025) dhe të tretë (2026 – 2030) parashikimet prezantohen për zërat kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke reflektuar strategjinë financiare të parashikuar për financimin e investimeve kapitale.

Si pjesë e politikës së PIK, procesi është kryer në mënyrë të tillë që të ofrojë informacionin e nevojshëm edhe për vendodhjen gjeografike të investimit, duke i specifikuar investimet (sa herë është e mundur) sipas njësive administrative që përbëjnë Bashkinë e Fierit.

Më poshtë do të ndalemi kryesisht në detajimin e strategjisë financiare të propozuar prej Bashkisë së Fierit për të mundësuar realizimin e investimeve/përmirësimeve të listuara.

Burimi kyesor i vetë Bashkisë së Fierit për financimin e PIK është teprica operative neto (TON). TON do të përcaktohet si diferenca midis të ardhurave korente dhe shpenzimeve korente (Figura 2., Financimi i investimeve kapitale). Konvencionalisht, të ardhurat korente do të identifikohen si diferencë e të ardhurave totale me të ardhurat kapitale (të ardhura nga shitja e aseteve dhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë). Shpenzimet korente do të quhen të kategoritë e shpenzimeve për personel dhe për shpenzime operative. Diferenca midis këtyre dy kategorive do të japë atë që quhet tepricë operative (TO).


Figura 2. Financimi i investimeve kapitale



Burimi: Manuali për hartimin e planit të investimeve kapitale, Co-PLAN 2008

Nga ky përkufizim bëhet e qartë se niveli i TON është funksion i performancës fiskale të bashkisë nga njëra anë – pra rritjes së të ardhurave prej taksave, tarifave si dhe e mundësive të tjera alternative të financimit, dhe nga ana tjetër, përmirësimit të menaxhimit financiar, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative dhe eficientimit të stafit vendor (Figura 3., Krijimi i hapësirës për projekte të reja).

Figura 3. Planifikimi financiar – të krijosh hapësirë për projekte të reja



Burimi: Plani Strategjik i Zhvillimit dhe Buxheti Afatmesëm me Bazë Performancën, dldp 2012

Pikërisht në këto dy drejtime kryesore fokusohet edhe strategjia financiare e Bashkisë së Fierit për 15 vitet e ardhshme: (i) nga njëra anë përmirësimit të performancës nga

ana e të ardhurave nëpërmjet mirë-menaxhimit financiar dhe eksplorimit të burimeve alternative të financimit; dhe (ii) nga ana tjetër reduktimit të shpenzimeve operative nëpërmjet eficientimit të stafit vendor.

Përmirësimi i performancës në kahun të ardhurave vendore do të mundësohet si rezultat i disa faktorëve dhe masave të parashikuara, si më poshtë:

- mirë-administrimi dhe menaxhimi i taksave vendore, dhe veçanërisht i taksës mbi pasurinë e paluajtshme (taksës mbi ndërtesën, tokën bujqësore dhe truallin);
- prezantimi i instrumenteve të rinj financiarë (si tarifatat e përmirësimit të infrastrukturës vendore, bonusit të intensitetit, programet e transferimit të drejtës së zhvillimit apo programet e financimit nëpërmjet rritjes së taksave specifike, etj.), të cilat jo vetëm do të mundësojnë administrimin e mirë të territorit të Bashkisë së Fierit, por do të ofrojnë një instrument të qenësishëm financiar për mbulimin e kostove të infrastrukturave të përmirësuara, apo zonave urbane të rivitalizuara;
- vënia në shfrytëzim e objekteve dhe pronave të Bashkisë duke mundësuar eficientimin e përdorimit të tyre nëpërmjet skemave të partneritetit publik privat;
- eksplorimi i mëtejshëm skemave të partneriteteve me sektorin privat në ofrimin e shërbimeve publike, si transporti publik, sportet dhe qendrat rekreative, menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, pikat e grumbullimit për produktet bujqësore, etj..

Përsa i përket rritjes së TON, nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve operative, Bashkia e Fierit parashikon marrjen e një sërë masash si më poshtë:

- përmirësimin e praktikave në ofrimin e shërbimeve vendore dhe eficientimin e kostove të tyre nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit;
- riorganizimit të disa shërbimeve vendore nëpërmjet eksplorimit të mëtejshëm të skemave të partneritetit me sektorin privat;
- reduktimit të kostove administrative nëpërmjet përmirësimit/rikonstruksionit të objekteve vendore duke mundësuar eficiencën energjitike.

Së fundmi, në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiare si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH, etj.) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) apo edhe format e partneritetit publik privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

Kjo strategji financiare është prezantuar dhe diskutuar me publikun përgjatë takimeve të zgjeruara të organizuara në kuadër të hartimit të PPV-së dhe ka marrë aprovimin e tij, në funksion të realizimit të vizionit të Bashkisë së Fierit:

“Zhvillimi i Bashkisë Fier do të udhëhiqet nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe do të ketë në fokus mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve të saj, mbështetur në një mjedis të shëndetshëm dhe me aftësi vetë-ripërtëritëse. Koncepti i zhvillimit të Fierit shkon përtej atij ekonomik, duke synuar gjithmonë e më tepër që ky i fundit të harmonizohet me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe, promovimin e zhvillimit intelektual, si shtylla që do të garantojnë që nga ky zhvillim të përfitojnë të gjithë qytetarët, duke menduar gjithmonë edhe për t’u trashëguar brezave të ardhshëm një territor të frytshëm e mjedis të shëndetshëm.

Bashkia Fier do të konsolidojë profilin e saj si pol i zhvillimit ekonomik rajonal, përmes diversifikimit të ekonomisë së saj dhe krijimit të kushteve për rritjen e konkurrueshmërisë së kësaj Bashkie në nivel vendi dhe më gjerë. Ne besojmë tek parimi i subsidiaritetit, ndaj synojmë që polet e zhvillimit ekonomik t’i decentralizojmë në të gjithë territorin e Bashkisë Fier, aty ku potencialet për zhvillim janë më të mëdha, më të përshtatshme për t’u përdorur dhe në harmoni me mjedisin.

Përtej të gjitha burimeve të shumta që disponon Bashkia, ne besojmë që aseti më me vlerë janë qytetarët e saj. ndaj rëndësi e veçantë do t’i jepet nxitjes së kualifikimit të burimeve njerëzore, për të rritur integritetin e të gjithë qytetarëve aktivë në tregun e punës. Kjo do të përkthehet në mbështetje dhe nxitje të arsimit të qytetarëve të bashkisë, në të gjitha ciklet, përfshirë atë profesional, duke maksimizuar kushtet për ta bërë këtë brenda Bashkisë Tonë.

Ne synojmë të ofrojmë të njëjtin standard shërbimesh në të gjithë territorin e Bashkisë, me qëllim zbutjen e pabarazisë sociale dhe ekonomike të banorëve të saj. Qëllimi është të zvogëlojmë sa më shumë të mundemi diferencën urbane-rurale përsa i përket cilësisë së shërbimeve publike si infrastruktura, arsim, shëndetësi si dhe ofrimin të mundësive për zhvillim ekonomik. Ndaj misioni në funksion të këtij vizioni zhvillimi do të jetë vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Fier”

Për hartimin e PIK është marrë në konsideratë edhe kuadri ligjor përkatës për financat vendore dhe konkretisht:

- Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012
- Ligj nr. 57/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2015 “Për Buxhetin e vitit 2016”;
- Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”;
- Ligji nr. 9764, datë 09.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”;
- Ligji nr. 142/2015 “Për ndryshime dhe amendime në ligjin nr. 9632”;
- Ligji nr. 10117, dt. 23.04.2009; ligji 10146, dt. 28.09.2009; ligji nr. 10073, 09.02.2009 “Per disa ndryshime në ligjin nr. 9632, dt. 30.10.2006 mbi sistemin e taksave vendre.”;

- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i amenduar;
- Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) numër 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores për Planifikimin e Territorit”;
- Udhëzim nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”;
- Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”;
- Udhëzim nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari”;
- Udhëzim nr. 34, datë 28.12.2015 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2016”;
- Udhëzim nr. 7/1, datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzim nr. 3, datë 16.01.2015 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- Udhëzim nr. 7, datë 11.02.2015 “Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limitit të angazhimeve”;
- Udhëzim nr. 8, datë 29.03.2012, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”.

2. Nevoja për investimeve kapitale dhe identifikimi i projekteve

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojës së Bashkisë së Fierit për investime kapitale është bërë nëpërmjet ndjekjes së hapave si më poshtë:

- Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës në qytet dhe nevojës së ardhshme për shërbime (shiko Tabela 1.). Është vlerësuar gjendja e infrastrukturave dhe shërbimeve të ndryshme publike dhe është grumbulluar informacion në lidhje me moshën, gjendjen, historinë e mirëmbajtjes dhe koston e zëvendësimit të infrastrukturave/shërbimeve publike.
- Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale për përmbushjen e objektivave strategjike të parashikuara në SZHT-në e Bashkisë: si p.sh. projektet urbane apo zhvilluese: krijimi i zonave të gjelbra, strehimi social, krijimi i zonave të reja të parkimit, etj.
- Rishikimi i projekteve të aprovuara më parë, për të mundësuar përditësimin e PIK, lidhjen e tij me dokumentet e tjera financiare (PBA dhe buxheti vjetor), dhe krijimin e një panorame sa më të plotë në lidhje me investimet kapitale në Bashki.

Tabela 1. dhe Tabela 2., sjellin një panoramë të situatës në lidhje me nevojën për infrastrukturë dhe shërbimeve publike në bashki, referuar aksesit që banorët kanë në to, për çdo njësi administrative.

Tabela 1: Inventari i infrastrukturës dhe shërbimeve publike në Bashkinë e Fierit

NJËSIA ADMINISTRATIVE										
	Fier	Frakull	Levan	Cakran	Qendër	Dermentas	Mbrostar	Topojë	Portëz	Libofshë
Popullsia	55,845	6,820	8,159	11,722	4,207	7,788	7,460	4,246	8,259	6,149
Toka e banueshme (ha)	669.4	224.9	283.7	586.3	117.3	260.4	220.6	114.6	352.2	297.9
Aksesi në infrastrukturë										
Rrugë (% e popullsisë)	100	98.9	97.9	95.5	99	99.4	99.1	99.2	94.8	99.4
Ujë (% e popullsisë)	-	100	100	100	100	67.4	100	100	54.3	100
KUZ (% e popullsisë)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Energji elektrike (% popullsisë)										
Aksesi në objekte të superstrukturës										
Kopësht (425m) (% sip. banimi e mbuluar)	51.32	44.82	42.33	27.37	46.64	45.6	42.76	72.57	24.01	30.3
Shkolle 9-Vjeçare (900m) (% sip. banimi e mbuluar)	85.85	73.45	69.75	65.31	77.43	59.74	74.88	81.39	66.2	61.69
Shkollë e mesme (2750m) (% sip. banimi e mbuluar)	92.4	81.79	32.68	43.79	73.7	77.81	36.93	44.26	43.35	65.8
Qendra shëndetësore (1 qendër shëndetësore/ 10,000 banorë) (% e popullsisë)	53	100	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Përpunuar Co-PLAN nga Bashkia Fier, 2016

Kësaj panorame i shtohet plani i veprimit i hartuar në kuadër të SZHT-së, në të cilin janë identifikuar projektet dhe ndërhyrjet kryesore kapitale për realizimin e objektivave strategjike, si dhe lista e investimeve kapitale prioritare të miratuar së bashku me buxhetin e vitit 2016. Mbi këtë bazë është ndërtuar tabela e projekteve kapitale e cila përmbledh informacionin në lidhje me: (i) titullin e projektit, (ii) programin dhe objektivin strategjik në të cilin kontribuon realizimi i projektit; (iii) vendndodhjen gjeografike dhe administrative; (iv) vlerën e projektit; (v) kohën e zbatimit të tij; si dhe (vi) burimin e financimit.

Tabela 2: Mbulimi i popullsisë së njësive administrative të Bashkisë së Fierit me shërbime vendore

NJËSIA ADMINISTRATIVE										
	Fier	Frakull	Levan	Cakran	Qendër	Dërmentas	Mbrostar	Topojë	Portëz	Libofshë
Popullsia me shërbime të mbuluara	55,845	6,750	7,992	1,206	4,168	7,743	7,399	4,213	7,837	6,118
Popullsia pa shërbime të mbuluara	0	70	167	516	39	45	61	33	422	31
Gjithsej popullsia	55,845	6,820	8,159	11,722	4,207	7,788	7,460	4,246	8,259	6,149

Burimi: Përpunuar Co-PLAN nga Bashkia Fier, 2016

3. Kapaciteti financiar i Bashkisë Fier


3.1 Analiza financiare 2010-2015

Analiza e aktivitetit financiar për Bashkinë Fier u realizua me përdorimin e të dhënave nga Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit), pranë Ministrisë së Financave. Përdorimi i këtij burimi justifikohet me faktin se arrihet të sigurohen seri kohore për periudhën 2010 – 2015 për të gjitha njësitë administrative përbërëse të Bashkisë së re Fier. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel njësie administrative në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie.

3.1.1 Të ardhurat

Të ardhurat totale të Bashkisë Fier vlerësohet të kenë ndjekur një prirje përmirësuese përgjatë periudhës 2010 – 2015. Norma mesatare vjetore e rritjes së të ardhurave gjatë kësaj periudhe rezultoi të jetë rreth 4.4%, ndikuar ndjeshëm prej rënies së tyre në vitet 2011 dhe 2012. Në total, të ardhurat në dispozicion të Bashkisë Fier janë luhatur në intervalin 1.5 – 2.4 miliard lekë. Në vitin 2015, burimet financiare në dispozicion të Bashkisë Fier shënuan vlerën 2.4 miliard lekë, në rritje me rreth 18.8% në terma vjetorë.


Figura 4. Ecuria e të ardhurave totale dhe ndryshimet vjetore



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Në linja të përgjithshme, përcaktues i kahut të zhvillimeve në të ardhurat totale për Bashkinë Fier rezulton të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare¹. Përgjatë periudhës në analizë, të ardhurat totale u përbënë mesatarisht për rreth 75% nga të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare, përkundrajt 25% nga të ardhurat vendore. Peshat e lartë e transfertave ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave bënë që, ndryshime të vogla në nivel qendror në lidhje me këtë kategori të ardhurash të kenë efekt të rëndësishëm në sjelljen e të ardhurave totale të Bashkisë Fier, për pasojë lirshmërisë së saj në ndërmarrjen e projekteve të investimeve në mënyrë të pavarur.


Figura 5. Kontributi i kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave totale



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Analiza në terma kontributësh konfirmon edhe një herë varësinë e Bashkisë Fier nga të ardhurat ndërqeveritare. Përgjatë të gjithë periudhës në analizë, kahu i zhvillimeve në të ardhurat totale është përcaktuar në masën më të madhe nga ecuria e të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare. Megjithatë, duke filluar prej vitit 2014, kontributi i të ardhurave vendore në ecurinë e të ardhurave totale ka ndjekur prirje rritëse, duke pothuajse barazuar në vitin 2015. Bilancimi në terma kontributësh rezulton të jetë frut i rritjes së peshës së të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave si dhe rritjes nominale të tyre në terma vjetorë.

Figura 6. Të ardhurat vendore dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016


Pavarësia financiare e Bashkisë Fier, matur nga raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave vlerësohet relativisht e ulët përgjatë periudhës 2010 - 2015. Autonomia financiare regjistroi nivelin maksimal në vitin 2012 me rreth 31.3% dhe

nivelin më të ulët në vitin 2010 me rreth 21.5%. Në vitin 2015, niveli i autonomisë financiare të Bashkisë Fier i matur si raporti i të ardhurave vendore ndaj totalit të të ardhurave shënoi nivelin 27.2%, në rritje me rreth 4.3 pikë përqindjeje krahasuar me nivelin e treguesit një vit më parë.

Në terma të përgjithshëm, niveli i të ardhurave vendore përcaktohet na masën më të madhe nga performanca e *taksave dhe tatimeve vendore*. Mesatarisht, të ardhurat nga taksat dhe tatimet vendore kanë përfaqësuar rreth 70.4% të të ardhurave totale gjatë viteve 2010 – 2015. Kategoria e dytë me peshën më të lartë në përbërjen e të ardhurave vendore përfaqësohet nga të ardhurat nga *tarifat vendore* të cilat përfaqësojnë mesatarisht 16.6% të tyre për t'u ndjekur me të ardhurat nga *asetet* me mesatarisht 12.5%. Të ardhurat e tjera (të cilat përfshijnë të ardhura si donacione, dhurata etj) kanë një peshë të ulët në totalin e të ardhurave vendore.

Niveli i të ardhurave nga taksat dhe tatimet, ndër vite, është përcaktuar gjerësisht nga të ardhurat e gjeneruara nga *taksat e pronës (tokë bujqësore dhe ndërtesa), taksa mbi biznesin e vogël (tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël) dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë* nga ndërtimet e reja. Taksat e pronës (taksa mbi ndërtesat dhe ajo mbi tokën bujqësore) si dhe taksa e truallit² shihen i taksa me kontribut potencial të lartë në rritjen e të ardhurave vendore si dhe përmirësimin e pavarësisë financiare të Bashkisë Fier.

Figura 7. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të të ardhurave




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Të ardhurat nga tarifat vendore kanë qenë të luhatshme ndër vite por, performanca e tyre në total udhëhiqet nga ecuria e të ardhurave nga *tarifa e pastrimit dhe higjenës*. Të ardhurat e gjeneruara nga menaxhimi i aseteve në dispozicion përbëjnë një element të rëndësishëm në strukturën e të ardhurave vendore. Për më tepër, implementimi i sistemeve për menaxhimin e aseteve mund t'i transformojë ato në një burim akoma më të rëndësishëm financiar për Bashkinë Fier.

Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare të Bashkisë Fier, rezultojnë të jenë një element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia në terma financiarë nga kjo kategori të ardhurash kushtëzon ndjeshëm

planifikimin e shpenzimeve kapitale (investimeve) të Bashkisë Fier. Në vitin 2015, të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare shënuan vlerën 1.7 miliard lekë, në rritje me rreth 12.2% krahasuar me një vit më parë. Sipas elementëve përbërës, peshën më të madhe e zënë të ardhurat nga *transferta e kushtëzuar* e cila në vitin 2015 përfaqësoi rreth 76.0% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare (mesatarja 2010 – 2015 është 69.2%). Mesatarisht, rreth 76% e kësaj transferte vjen nga Minsitria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë.

Figura 8. Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016


Të ardhurat nga *transferta e pakushtëzuar* përfaqësuan mesatarisht 26.1% të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare. Teorikisht dhe në ndryshim nga transfertat e kushtëzuara, për këtë kategori të ardhurash pushteti vendor gëzon autonomi të plotë në përdorim (përfshijë rastet kur qeveria qendrore udhëzon ndryshe). Në praktikë, ky burim të ardhurash rezulton të jetë shumë i rëndësishëm dhe i qenësishëm në tërësinë e mjeteve financiare në dispozicion të Bashkisë Fier. Mesatarisht, niveli i të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar është i krahasueshëm me totalin e të ardhurave vendore (të ardhurat nga taksat, tarifat, asetet dhe të ardhurat e tjera). Të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndara rezultojnë në një kontribut më të ulët ndaj totalit të të ardhurave nga transfertat ndërqeveritare dhe paraqiten të luhatshme në kohë (si pasojë e ndryshimeve legjislative të ndodhura).

3.1.2 Shpenzimet

Në përputhje me nivelin e të ardhurave totale, Bashkia Fier realizon shpenzime për të siguruar vijimësinë institucionale, ushtrimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe kompencave të përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 “*Mbi vetëqeverisjen vendore*”, në territorin në administrim përcaktuar nga ligji nr. 115/2014 “*Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*”.

Gjatë vitit 2015, shpenzimet totale të Bashkisë Fier shënuan një vlerë prej 2.1 miliard lekë, në rënie të lehtë prej 1.6% krahasuar me shpenzimet e kryera një vit më parë. Nisur nga fakti se viti 2015 u karakterizua nga ndryshime të mëdha, Bashkia Fier u përball me një situatë në të cilën, territori nën administrim dhe popullsia për tu shërbyer u rritën ndjeshëm, të gjitha këto të përkthyeshme në terma financiarë. Në këtë kontekst, nevoja për mjete financiare rezulton të jetë e lartë si për shpenzime administrative ashtu dhe për shpenzime kapitale, veçanërisht në njësitë administrative (ish-komunat) që iu bashkëngjiten Bashkisë së vjetër Fier.

Figura 9. Shpenzimet sipas qëllimit të përdorimit dhe ndryshimi vjetor i tyre



Burimi: Ministria e Financave & përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Ndër vite, struktura e shpenzimeve të Bashkisë Fier rezulton të jetë dominuar nga shpenzimet operative dhe ato të personelit (për paga dhe sigurime). Shpenzimet operative të Bashkisë Fier mesatarisht përfaqësuin rreth 57.6% të shpenzimeve totale të kryera gjatë viteve 2010 - 2015. Në vitin 2015, shpenzimet operative shënuan një vlerë prej rreth 1 miliard lekë, në tkurrje me rreth 13.8% krahasuar me nivelin e tyre të një viti më parë.


Kategoria e dytë e shpenzimeve me peshë më të madhe ndaj totalit të shpenzimeve, ato të personelit përfaqësuin mesatarisht rreth 25.1% ndaj totalit të shpenzimeve përgjatë periudhës 2010 – 2015. Në vitin 2015, shpenzimet për personelin rezultojnë të jenë reduktuar me rreth 15% në terma vjetorë, duke përfaqësuar rreth 22% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2015.

Të dyja këto kategori (shpenzime personeli dhe operative) përfaqësuin mesatarisht rreth 82.6% të shpenzimeve totale të ndërrmarra nga Bashkia Fier për periudhën 2010 – 2016. Për vitin 2015, shpenzimet operative dhe të personelit përfaqësuin rreth 73% të shpenzimeve totale, vlerë kjo nën mesataren e periudhës së konsideruar.

Kategoria e shpenzimeve kapitale përfaqësoi mesatarisht rreth 17.4% të shpenzimeve totale të Bashkisë Fier përgjatë periudhës 2010-2015. Pas vitit 2013, shpenzimet

kapitale të kryera nga Bashkia Fier u mëse dyfishuan në vitin 2014 dhe shënuan rritje me rreth 61.3% në vitin 2015.

Figura 10. Kontributi sipas kategorive në ndryshimin vjetor të shpenzimeve




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Analiza në terma kontributesh konfirmon dominimin e shpenzimeve administrative (personel dhe operative) përgjatë periudhës së konsideruar. Ajo që vlen të theksohet është balancimi deri diku i kontributit të këtyre dy kategorive në favor të shpenzimeve kapitale në dy vitet e fundit. Kështu, duke filluar prej vitit 2014, vihet re një rritje e qenësishme e shpenzimeve kapitale dhe kontribut pozitiv i tyre në shpenzimet totale.

3.1.3 Teprica operative neto dhe buxheti kapital

Me përjashtim të vitit 2012 i cili rezulton të ketë qenë viti me vështirësi financiare më të mëdha, teprica operative ka shënuar nivele pozitive. Duke filluar prej vitit 2013, teprica operative ka ndjekur prirje rritëse duke u materializuar në rreth 856.0 milionë lekë në fund të vitit 2015. Ky nivel i tepricës operative përfaqëson rreth 36.1% të të ardhurave operative të Bashkisë Fier në vitin 2015 dhe sinjalizon për një orientim të qartë drejt ndërmarrjes së investimeve kapitale. Për sa kohë që aksesit në burimet financiare nga grantet konkurruese, burimet ndërkombëtare dhe forndet e donatorëve paraqesin një parashikueshmëri të ulët, teprica operative (dhe teprica operative neto) përbëjnë burimin kryesor mbi bazën e të cilit të ngrihen parashikimet për financimin e projekteve kapitale.

Figura 11. Teprica operative neto




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Buxheti kapital në dispozicion të Bashkisë Fier do të përcaktohet si shuma e mjeteve financiare nga teprica operative, të ardhurat kapitale nga shitja e aseteve, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, të ardhura nga huaja, donacionet dhe të ardhura nga taksa të përmirësimit apo instrumentë të tjerë të posaçëm të zhvillimit. Të gjitha këto përbëjnë atë që gjerësisht konsiderohet si buxhet kapital dhe që për Bashkinë Fier rezultojnë të ketë shënuar vlera pozitive përgjatë periudhës 2010 – 2015.

Ndërkohë që gjatë periudhës 2010 – 2011 shpenzimet kapitale kanë qenë të barabarta apo më të ulëta krahasuar me buxhetin kapital në dispozicion, në periudhën 2012 – 2014, shpenzimet kapitale rezultuan mbi nivelin e të ardhurave kapitale. Situata rezultoi e përmbysur pozitivisht në vitin 2015, ku totali të ardhurave kapitale rezultoi të jetë ndjeshëm më i lartë se ai i shpenzimeve kapitale të realizuara. Kështu, të ardhurat apo buxheti kapital për vitin 2015 rezultoi në rreth 876 milionë lekë përkundrajt një niveli shpenzimesh kapitale pres rreth 566.7 milionë lekësh.


Figura 12. Të ardhura dhe shpenzime kapitale



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Shpërndarja sipas programeve buxhetore e buxhetit kapital përgjatë periudhës 2010 - 2015 pasqyron dhe orientimin strategjik të bashkisë në kohë. Në vitet 2010 – 2011, investimet kapitale ishin të përqëndruara në arsim (pavarësisht burimit të financimit) ndërsa në dy vitet e fundit evidentohet një orientim i qartë drejt programit buxhetor të “Çështjeve Ekonomike” ku, ndër të tjera, përfshihen edhe investimet e lidhura me menaxhimin e transportit rrugor (rreth 486 milionë lekë).

Figura 13. Shpenzimet kapitale sipas programeve buxhetore



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

4. Përzgjedhja e projekteve kapitale prioritare

Identifikimi dhe vlerësimi i projekteve kapitale është bërë në përputhje me objektivat strategjik të SZHT-së, të reflektuar gjithashtu edhe në propozimet e PPV-së. Referuar pamundësisë së financimit të të gjithë projekteve të identifikuar në tabelën përmbledhëse të nevojave për investime kapitale, është bërë procesi i prioritarizimit dhe përzgjedhjes së projekteve të investimeve mbi bazën e një sërë kriteresh të dakordësuara me aktorët. Kriteret marrin në konsideratë tre çështje kryesore: (i) koston e investimit; (ii) jetëgjatësinë dhe kohën e përdorshme të investimit; (iii) koston e mirëmbajtjes.

Mbi bazën e këtyre tre çështjeve lista e kriterëve që investimet kapitale duhet të plotësojnë në procesin e prioritarizimit të tyre është si më poshtë:

- kontributi i projektit në prioritetet strategjike: sa dhe si kontribuon projekti në arritjen e objektivave strategjik;
- natyra e projektit: a ndikon projekti në parandalimin/eliminimin e një situatë urgjente/të rrezikshme;
- statusi i projektit: a është projekt në vazhdim apo projekt i ri dhe si është identifikuar;
- vendndodhja gjeografike/administrative: cila është zona e mbuluar nga projekti dhe në cilën njësi administrative kontribuon/shtrihet ai;
- kohëzgjatja e shlyerjes së koston të projektit: a mundet projekti të gjenerojë të ardhura në buxhetin vendor? Kur dhe për sa kohë mund të ndodhë kjo?;
- mundësia e financimit të projektit: a financohet projekti prej buxhetit vendor kapital, apo prej programeve të qeverisë qendrore (QQ)/donatorëve/etj);

5. Mundësitë e financimit dhe mobilizimi i të ardhurave

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe të objektivave strategjike të përshkruar në Strategjinë e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë Fier, rezulton thelbësor përkthimi në terma sasiorë (monetar) i tyre. Për këtë qëllim, projektet e investimeve sipas programeve kuantifikohen dhe shpërndahen ndër vite (fazohen në kohë). Materializimi i projekteve të investimeve në përmbushje të vizionit të Bashkisë Fier varet shumë nga buxheti kapital apo mjetet financiare në dispozicion të bashkisë.

5.1 Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve

Parashikimi i të zërave të të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin 2016 është marrë nga projekt buxheti i Bashkisë së Fierit për vitin 2016. Për periudhën 2017 – 2019, parashikimet u marrën nga Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2017 – 2019 dhe mbi bazën e supozimeve të PBA-së seritë kohore u zgjatën deri në vitin 2020. Për periudhën 2020 – 2030, parashikimet u kryen duke konsideruar trendin e përgjithshëm të ndjekur nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së mëparshme, normat rritëse të parashikuara në PBA 2017 – 2019, parashikimet e përgjithshme për treguesit makroekonomikë të publikuar nga Ministria e Financave.

Parashikimet për të ardhurat dhe shpenzimet vendosen në një kontekst makroekonomik të qëndrueshëm i cili karakterizohet nga:

- normë inflacioni e qëndrueshme dhe pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë për 3%;
- kurs këmbimi me valutat kryesore (euro dhe dollar amerikan) i qëndrueshëm pa goditje permanente dhe të qenësishme;
- rritje e moderuar e popullsisë;
- rritje nominale dhe reale e ekonomisë pranë vlerës potenciale;
- rënie e ngadaltë por progresive e papunësisë;
- tregues fiskalë (defiçit buxhetor dhe borxh qeverie) pranë niveleve të përshkruara nga Traktati i Maastricht-it;
- qëndrueshmëri e bilancit të pagesave (llogari korente dhe financiare).

Normat e rritjes së treguesve të ndryshëm për të ardhurat dhe për shërbimet do të aplikohen në mesataren rrëshqitëse të 5 viteve paraardhëse.

Tabela 3: Supozime bazë për parashikimin e të ardhurave

	2021-2025	2026-2030
Taksa dhe tatime	+5.0%	+7.0%
Tarifa vendore	+10.0%	+5.0%
Asete	+10.0%	+10.0%
Të tjera	+10.0%	+5.0%
Transferta e kushtëzuar	+7.0%	+10.0%
Transferta e pakushtëzuar	+10.0%	+10.0%
Transferta specifike	-	-
Taksa dhe tatime të ndara	+10.0%	+10.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Nisur nga norma mesatare e rritjes së të ardhurave nga taksat dhe tatimet, supozimet e aplikuara për periudhën 2016-2020 dhe niveli aktual i mbledhjes së tyre vlerësohet se një normë rritjeje prej 5% në fazën e parë dhe 7% në fazën e dytë është e përshtatshme. Përsa i përket tarifave, në fazën e parë synohet rritje me rreth 10% dhe në të dytën 5%. Të ardhurat nga asetet vlerësohen me potencial të lartë për rritjen e të ardhurave të Bashkisë Fier dhe përmirësimi në menaxhimin e tyre do të mund të përkthehet në një rritje të të ardhurave me 10% në fazën e parë dhe të dytë. Në lidhje me transfertat ndërqeveritare, duke marrë në konsideratë ndryshimet e mundshme legjislative (ligji për financat vendore) vlerësohet që transfertat e pakushtëzuar të rritet me 10% në të dy fazat e konsideruara ndërsa transfertat e kushtëzuar të rritet me 7% në vitet 2021-2025 dhe me rreth 10% në periudhën 2026-2030. Duke filluar prej vitit 2021, transfertat specifike vlerësohet të mos jetë më si instrument (më vete) nisur nga fakti se në harkun e pesë viteve pas marrjes së funksioneve të reja ato të jenë përbrendësuar nga Bashkia Fier dhe fondet (për ti ushtruar në kohë) për to do të jenë të përfshira në totalin e transfertës së kushtëzuar.


Tabela 4: Supozime bazë për parashikimin e shpenzimeve

	2021-2025	2026-2030
Personel	+2.0%	+3.0%
Operative	+2.0%	+1.0%
Kapitale	+10.0%	+10.0%

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

Shpenzimet për personelin vlerësohet të rriten me rreth 2% në fazën e parë dhe me rreth 3% në fazën e dytë. Rritja e efieciencës dhe efikasitetit në menaxhimin e Bashkisë si dhe nevojat për investime, vlerësohet një rritje e moderuar me 2 dhe 1% e shpenzimeve operative të Bashkisë Fier. Nga ana tjetër, moderimi në shpenzime korente do të pasqyrohet në rritje të nivelit të investimeve me 10% përgjatë të gjithë periudhës së parashikimeve.

Figura 14. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016


*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Në total, vlerësohet se Bashkia Fier do të ketë një nivel të ardhurash më të lartë se shpenzimet (si pasojë e një ritmi rritjeje në të ardhura më të lartë se ai në shpenzime). Ky skenar mund të konsiderohet si një variant neutral, ndjekës i prirjeve historike (deri diku të moderuar) të treguesve.

5.2 Parashikimi i tepricës operative dhe buxhetit kapital

Në vijim të parashikimeve për të ardhurat dhe për shpenzimet, llogarisim tepricën operative për të gjithë periudhën e konsideruar. Për periudhën 2016-2030, vlerësohet se teprica operative e Bashkisë Fier do të jetë pozitive dhe në terma të konsiderueshëm. Kështu, për periudhën 2016-2020, teprica operative do të jetë pozitive duke u vlerësuar në mesatarisht rreth 18.7% e të ardhurave korente. Më tej, në periudhën 2021-2025 teprica operative vlerësohet të ulet në mesatarisht 13.5% e të ardhurave korente. Konsolidimi i Bashkisë Fier si në terma insitucionalë ashtu dhe funksionalë do të materializohet në një aktivitet financiar të qëndrueshëm dhe tepricë operative pozitive, e vlerësuar në rreth 19.8% të të ardhurave korente të parashikuara për periudhën 2026-2030.

Figura 15. Parashikimi i tepricës operative neto




Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Teprica operative së bashku me të ardhurat kapitale japin buxhetin kapital për periudhën e zgjedhur në dispozicion të Bashkisë Fier për të ndërmarrë dhe realizuar investimet kapitale të synuara.

Figura 16. Parashikime për buxhetin kapital, 2016 – 2030



Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga Bashkia Fier dhe Co-PLAN, 2016

*2021-2025 dhe 2026-2030 janë vlera mesatare.

Bazuar në të dhënat financiare historike, parashikimet e përfshira në dokumentin e PBA-së, supozimeve të ndërmarra për parashikimin e zërave kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton një buxhet kapital pozitiv në dispozicion të Bashkisë Fier. Në terma nominalë, buxheti kapital në dispozicion për financimin e projekteve të investimeve vlerësohet të ndjekë një prirje rritëse në kohë si pasojë e përmirësimit të menaxhimit fiskal dhe financiar të Bashkisë. Megjithatë, diferencat ekzistuese në nivelin e ofrimit të shërbimeve, zhvillimit ekonomik dhe pabarazitë sociale midis njësisve administrative përbërëse kërkojnë një fluks të lartë investimesh për të siguruar deri diku zbutjen e tyre. Ndaj, krahas buxhetit kapital në dispozicion të bashkisë, energji të mëtejshme do të duhet të orientohen në gjetjen e burimeve financiare alternative: huatë bankare nga sistemi bankar vendas (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërorë të ofruara në baza konkurrionale (FZHR, FSHZH, AZHR etj.), fondet nga burime ndërkombëtare (IPA, BB) apo donatorë të ndryshëm (USAID, KfW etj).

6. Fishat e projekteve kapitale³

FISHË PROJËKTI 1 (O3P3 PR7)	
Titulli i Projektit	PR7 Zgjerimi i Pyllit të Levanit dhe kthimi i tij në park
Konteksti i Projektit	Pylli i Levanit ka një sipërfaqe prej 200 hektarë dhe ndodhet në njësinë administrative të Levanit. Kjo hapësirë është shpallur “rezervat natyror i menaxhuar/park natyror” dhe është i mbrojtur nga një zonë buferike prej 50 metrash. Aktualisht pylli është i organizuar krejtësisht në mënyrë spontane dhe pranë tij nuk ka asnjë shërbim ndihmës dhe argëtues për qytetarët.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë zgjerimin e pyllit të Levanit në pjesën juglindore të tij dhe kthimin e tij në park. Kthimi i pyllit në park do të arrihet nëpërmjet shtimit të elementëve të peizazhit si dhe ofrimit të shërbimeve ndihmëse dhe argëtuese për qytetarët. Projekti do të ketë për qëllim projektimin e një parku publik në të cilin banorët do të kenë mundësi të kryejnë aktivitete të ndryshme. Projekti do të sigurojë që parku të jetë i aksesueshëm duke siguruar kalime këmbësorësh dhe biçikletash, hapësira shlodhëse dhe elementë ujorë. Gjithashtu, do të ndërtohet një kompleks sportiv, i cili do të vihet në shërbim të banorëve të Bashkisë Fier por edhe turistëve. Për këtë qëllim do të hartohet një nën-projekt mbështetës teknik dhe arkitektonik i cili do të projektojë kompleksin sportiv. Kompleksi sportiv do të jetë në funksion të aktiviteteve që do t’i shtohen Parkut të Levanit dhe do të ndërtohet me materiale miqësore me mjedisin për të mos shkaktuar asnjë efekt mjedisor në florën dhe faunën e pyllit.
Partnerët	Bashkia Fier, Ministria e Mjedisit, Ministria e Zhvillimit Urban, Sektori privat
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Transformimi i pyllit të Levanit në park funksional dhe mikpritës për qytetarët dhe turistët; • Zgjerimi i tij do t’i shërbejë një numri më të madh qytetarësh dhe do të kthehet në një “frymëmarrje” të re për territoret e njësisë administrative pranë; • Ndërtimi i kompleksit sportiv do të pasurojë parkun me aktivitete dhe do të nxisë qytetarët drejt aktiviteteve sportive.
Objektivi	Objektivi O3: “Mbrojtja e ripërtëritja e burimeve natyrore”; Programi P3: “Hartimi dhe zbatimi i planit afatmesëm për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave lokale; Mbrojtja dhe zgjerimi i pyllit të Levanit.”
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Hartimi i projekt idesë dhe projektit teknik; • Vendosja e bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit; • Sigurimi i lejes mjedisore; • Promovimi i pyllit të Levanit si destinacion turistik
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetës së qytetarëve; • Përmirësimi i aksesit dhe hapësirave çlodhëse në park; • Përmirësim i funksionalitetit të parkut; • Shtimi i hapësirave për aktivitetet sportive.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i projektit ka nevojë për investime për ndërtimin fizik të kompleksit sportiv dhe hapësirave çlodhëse të parkut; • Projekti do të ketë nevojë për pajisjen me leje mjedisore; • Ekziston mundësia e keqpërdorimit të parkut dhe dëmtimit të ekosistemeve pas pajisjes së parkut me aktivitete dhe ambiente çlodhëse.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 2 (O5P1_PR1)	
Titulli i Projektit	PR1 Ndërtimi i spitalit rajonal pranë Pyllit të Levanit
Konteksti i Projektit	Sot, bashkia e re Fier dhe bashkitë e tjera fqinje vuajnë nga mungesa e shërbimeve spitalore të specializuara. Për këtë arsye, vlerësohet nevoja e ndërtimit të një spitali rajonal në bashkinë e Fierit, qendra e Qarkut të Fierit. Projekti konsiston në hartimin e projektit arkitektonik dhe inxhinierik të spitalit rajonal si dhe zbatimin e tij pranë Pyllit të Levanit
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë të ndërtojë një qendër kurimi dhe rehabilitimi me të gjitha specialitetet e trajtimit mjekësor. Ai përfshin hartimin e projektit të spitalit si dhe zbatimin e tij. Spitali do të kthehet në qendrën më të madhe në rajon me pajisje dhe ambiente bashkëkohore si dhe staf të specializuar. Nëpërmjet këtij projekti synohet të vihet në shërbim të banorëve rreth 400 shtretër. Vendndodhja e projektit pranë Pyllit të Levanit do ta bëjë këtë spital të aksesueshëm nga qytetet e tjera fqinje si dhe do ta vendosë spitalin në një zonë periferike të qytetit, pranë hapësirave të gjelbra të Pyllit të Levanit.
Partnerët & Financues	Bashkia Fier, Ministria e Shëndetësisë, , komuniteti, sektori privat, FZHR, donatorë.
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt do të rrisë cilësinë e jetesës së banorëve nëpërmjet përmirësimit të shërbimit spitalor; • Spitali rajonal do të ndikojnë në përmirësimin e jetesës edhe për banorët e bashkive fqinje;
Objektivi	Objektivi O5: <i>“Zbutja e pabarazive dhe Infrastruktura sociale”</i> ; Programi P1: <i>“Përmirësimi i shërbimit spitalor përmes investimit në infrastrukturën spitalore rajonale.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Marrëveshje me Ministrinë e Shëndetësisë mbi hartimin dhe realizimin e projektit; • Sigurimi i marrëveshjeve me Universitetin e Fierit për të nxitur zhvillimin e degëve të mjekësisë me qëllim furnizimin e spitalit me staf të kualifikuar
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve; • Ulja e nivelit të sëmundjeve tek qytetarët; • Lehtësim i fluksit të qytetarëve nga Qarku i Fierit në ambientet spitalore të kryeqytetit.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i projektit ka nevojë për investime të shumta; • Rreziku i dëmtimit të zonës pyjore të Pyllit të Levanit; • Rrezik i mos arritjes së rekrutimit të një stafi të specializuar;
Faza e projektit	Projekt
Kosto e projektit	6,975,000,000.00 Lekë / 50,000,000.0 Euro
Prioriteti	Afatshkurtër

FISHË PROJËKTI 3 (O2P6 PR15)	
Titulli i Projektit	PR15: Rikonstruksion i Rrugës Pishë-Poro dhe i rrugës Kthesa e Qarrit-Kryqëzim i Darzezës
Konteksti i Projektit	Bashkia e Fierit ka potenciale të mëdha turistike të cilat duhet të shfrytëzohen me qëllim për të rritur ekonominë lokale. Por jo të gjitha destinacionet turistike të bashkisë janë të arritshme dhe të aksesueshme nga qytetarët vendas dhe turistët. Ndaj, vlerësohet e nevojshme që të tregohet një vëmendje e veçantë ndaj sigurimit të këtyre destinacioneve me infrastrukturë rrugore.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë të ndërtojë rrugën e “Pishë-Porosë” si dhe “Kthesa e Qarrit-Kryqëzimi i Darzezës”. Në fillim do të hartohet projekti inxhinierik si dhe më pas zbatimi i tij. Projekti do të bazohet në të gjithë parametrat teknike të domosdoshme, si asfaltimin, kanalizimet e ujërave të zeza, mbjelljen e pemëve, sinjalistikën rrugore, ndriçimin dhe sigurimin e trotuareve për këmbësorët. Projekti do të ndërtohet kryesisht në funksion të akomodimit të turistëve në fshatrat Pojan, Boçovë dhe Bashkim.
Partnerët/Financuesit	Bashkia Fier, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, komuniteti, sektori privat, Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, FZHR
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt do të rrisë cilësinë e jetesës së banorëve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave publike; • Projekti do t’i shërbejë komunitetit përreth dhe turistëve; • Do të rrisë aksesin drejt zonës së bregdetit dhe fshatrave turistike.
Objektivi	Objektivi O2: <i>“Zhvillimi rural: Bujqësi e Turizëm”</i> ; Programi P6: <i>“Mbështetja me infrastrukturat e nevojshme për zhvillimin e ekoturizmit në fshatrat Pojan, Boçovë dhe Bashkim.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Marrëveshje me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për asistencë teknike dhe financiare.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve; • Kthimi i fshatrave Boçovë dhe Bashkim në destinacione akomoduese për turistët; • Përmirësimi i aksesit drejt Pishë-Porosë dhe zonës bregdetare.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Gjetja e investimeve që nevojiten për projektin; • Kohëzgjatja për realizimin vlerësohet e lartë.
Faza e projektit	Koncept - Projekt
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 4 (O3P2_PR6)	
Titulli i Projektit	PR6: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjaturës së lumenjve Seman, Vjosë dhe Gjanicë
Konteksti i Projektit	Gjanica: lumi i Gjanicës sot vuan nga një ndotje e madhe mjedisore si pasojë aktiviteve industriale dhe bujqësore, erozionit ujor, urbanizimit si dhe zhdukjes së zonës ripariene. Projekti konsiston në analizimin e gjendjes mjedisore të Lumit të Gjanicës dhe rehabilitimin e zonës ripariene të tij.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të përfshijë fillimisht një analizë të detajuar të cilësisë së ujërave të lumit dhe evidentim të përshkueshmërisë së ujërave të ndotura në shtresat nëntokësore. Më pas do të rishikohet segmenti i përzgjedhur për ndërhyrje mbi bazën e një studimi para-fizibiliteti, për të përcaktuar zonën e ndërhyrjes. Gjithashtu do të evidentohen dhe do të shmangen ndotësit e lumit. Një tjetër ndërhyrje, pjesë e këtij projekti është rikthimi i zonave ripariene përgjatë lumit, zona në të cilat do të jetë e nevojshme të kryhen edhe prishje ndërtimesh si dhe ripyllëzime. Në përfundim, për të shmangur rrezikun e përmbytjeve dhe erozionin e brigjeve, veç rehabilitimit të zonës ripariene, do të ndërhyhet në disa segmente me korracim lumor vegetativ dhe/ose me gabione.
Partnerët&Financues	Bashkia Fier, Ministria e Mjedisit, komuniteti, sektori privat, FZHR
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së ujërave të lumit; • Ujërat e lumit do të jenë më të sigurt për përdorim në bujqësi; • Fasha e lumit do të mundësohet si zonë rekreative për qytetarët; • Rehabilitimi i kësaj fashe do të ndikojë ndjeshëm në shëndetin e qytetarëve; • Do të shmanget përmbytja e zonave të banimit nga lumi.
Objektivi	Objektivi O3: <i>“Mbrojtja e ripërtëritja e burimeve natyrore”</i> ; Programi P2: <i>“Rehabilitimi i shtretërve lumorë të Semanit, Vjosës dhe Gjanicës.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e studimit të para-fizibilitetit; • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit mbi hartimin dhe realizmin e projektit; • Sigurimi i marrëveshjeve me njësitë e tjera vendore si dhe bizneset për ndalimin e derdhjes së mëtejshme të ndotësve në Lumin Gjanica.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve; • Ulje e nivelit të ndotjes; • Mundësi e përdorimit të ujit të lumit për ujtitje; • Rritje e vlerës së tokave pas investimit në brigjet lumore.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Pamundësia për të siguruar fonde të mjaftueshme për ndërhyrje madhore ; • Nevoja për përfshirjen e disa aktorëve, përfshirë këtu edhe pronarët e ndërtimeve të kryera përgjatë fashës lumore; • Mungesa e vullnetit për bashkëpunim mes autoriteteve vendore në territoret e të cilave kalon Gjanica; • Mungesa e një strategjie për shmangien e burimeve industriale të ndotjes në Gjanicë, jashtë territorit të Fierit.
Faza e projektit	Koncept- Projekt
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 5 (O3P2_PR6)	
Titulli i Projektit	PR6: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjaturës së lumenjve Seman, Vjosë dhe Gjanicë
Konteksti i Projektit	Vjosa: Lumi Vjosa bën pjesë në ekonominë pyjore “Lumi Vjosë” dhe gjendet në pjesën veriore të rrjedhës së tij. Në shkurtin e vitit 2015 si pasojë e veprimtarisë së Lumit Vjosa u përmbytën territore të shumta bujqësore dhe urbane. Nga këto përmbytje u prekën banorë të njësinë administrative Levan dhe kryesisht banorët e fshatit Pishë dhe Darzezë e Re. Megjithatë përmbytje janë shkaktuar edhe në njësinë administrative Topojë. Përmbytjet kanë ardhur si rrjedhojë e mungesës dhe dëmtimit të brezit pyjor të Lumit Vjosa. Për këto arsye ndjehet e nevojshme që të hartohet një projekt i cili do të mundësojë rikrijimin e brezit pyjor mbrojtës kundër erozionit të mëtejshëm.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë përmirësimin dhe rehabilitimin e brezit pyjor të Vjosës në bashkinë e Fierit. Konkretisht brezi pyjor i cili do të rikrijohet ka një gjerësi prej 50 m gjerësi dhe gjatësi prej 10000 m. Projekti do të konsistojë në një projekt teknik i cili do të propozojë pyllëzimin e këtij brezi si dhe do të kryhet zbatimi i tij. Brezi pyjor do të plotësohet dhe zgjerohet nëpërmjet pyllëzimit me fidanë nga punonjësit e sektorit të gjelbërimit. Zbatimi i projektit do të kërkojë 4 muaj kohë, ndërsa rezultatet e mbjelljeve të para do të shihen pas një viti (80% e zënieve të para).
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, Ministria e Mjedisit, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Baseneve, komuniteti, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt pritet të ndikojë në përmirësimin fizik të tokave bujqësore dhe territoreve të tjera pranë; • Projekti do t’i shërbejë një numri më të madh banorësh dhe do të ndikojë ndjeshëm në mbrojtjen e pronave të tyre nga përmbytjet; • Projekti gjithashtu do të rezultojë në përmirësim të mëdha mjedisore si pasojë e ndërtimit të zonave ripariane.
Objektivi	Objektivi O3: “Mbrojtja e ripërtëritja e burimeve natyrore”; Programi P2: “Rehabilitimi i shtretërve lumorë të Semanit, Vjosës dhe Gjanicës.”
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Hartimi i projekt idesë dhe projektit teknik.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve; • Përmirësim i zonave ripariane; • Përmirësim i gjendjes fizike të shtratit të Lumit Vjosa; • Rritja e sigurisë së jetës së banorëve.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti ka nevojë për investime të mëdha për ndërtimin e veprave inxhinierike; • Vështirësi në arritjen e bashkëpunimit me njësitë e tjera vendore ku kalon Lumi i Vjosa.
Faza e projektit	Projekt
Vlera	13,468,708.50 Lekë
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 6 (O3P2_PR6)	
Titulli i Projektit	PR6: Rehabilitim dhe pyllëzim i brezit mbrojtës të argjinaturës së lumenjve Seman, Vjosë dhe Gjanicë
Konteksti i Projektit	Seman: ujërat e Lumit Seman për shkak të prurjeve të mëdha dhe materialeve të ngurta që sjellin me vete, dalin nga shtrati dhe shkaktojnë përmytje dhe erozion të madh në tokat bujqësore. Si rezultat i kësaj, është rrëzuar argjinatura në kilometrin e 41 dhe 40 të segmentit të saj. Ekziston një sipërfaqe prej 30 ha që është e papjellëzuar dhe ka nevojë për ndërhyrje.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë të kontribuojë në përmirësimin dhe rehabilitimin e fashës lumore të Semanit përgjatë gjithë shtrirjes së tij në Bashkinë e Fierit, por me fokus të veçantë në territoret e fshatrave Seman dhe Seman i Ri. Konkretisht, projekti do të përqendrohet në rikrijimin e zonës ripariane të lumit, sistemimi i shtratit dhe i digave ku do të jetë e nevojshme.
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, Bashkia Kuçovë, Bashkia Lushnje, Ministria e Mjedisit, Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Baseneve, komuniteti, FZHR, Donatorë
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt pritet të ndikojë në përmirësimin fizik të tokave bujqësore dhe territoreve të tjera pranë • Projekti do të shërbejë një numri më të madh banorësh dhe do të ndikojë ndjeshëm në mbrojtjen e pronave të tyre nga përmytjet • Projekti gjithashtu do të rezultojë në përmirësime të mëdha mjedisore si pasojë e rikrijimit të zonave ripariane • Nëpërmjet këtij projekti do të përfitojnë rreth 2000 familje në fshatrat Seman, Seman i Ri, Sheq, Marinas, Gjakalli, Grykë, Kavaklli, dhe Topojë
Objektivi	Objektivi O3: <i>“Mbrojtja e ripërtëritja e burimeve natyrore”</i> ; Programi P2: <i>“Rehabilitimi i shtretërve lumorë të Semanit, Vjosës dhe Gjanicës.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i konceptit të projektit dhe lobimi tek institucionet qendrore/rajonale për mundësi financimi; • Krijimi i bashkëpunimeve/partneritetit midis Agjencisë së Baseneve dhe njësisë të tjera vendore të përfshira; • Hartimi i studimit të parafizibilitetit, shoqëruar me vlerësim mjedisor për ndërhyrjet; • Hartimi i projekt idesë dhe Projektit Teknik dhe përgatitja e aplikimit në FZHR apo institucione të tjera, sipas rastit; • Hartimi i studimeve dhe analizave për të përcaktuar zonat të cilat kanë nevojë për ndërhyrje emergjente; • Të krijohet një rezervë prodhuese drusore dhe jo drusore për zonat që do të pyllëzohen; • Nisja e zbatimit të projektit me fonde të bashkisë vetëm në zonat të cilat janë në rrezik të madh/të shpejtë dhe kanë nevojë për ndërhyrje emergjente për shmangie të katastrofave natyrore nga moti; • Fushata e informimit dhe zbatimi i projektit pas miratimit të fondeve të plota.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetës së qytetarëve; • Përmirësim i zonave ripariane; • Përmirësim i gjendjes fizike të shtratit të Lumit Seman; • Rritja e sigurisë së jetës së banorëve.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti ka nevojë për investime për ndërtimin e veprave inxhinierike; • Mund të ketë vështirësi në arritjen e bashkëpunimit/partneritetit me njësitë e tjera vendore ku Lumi i Semanit kalon.
Faza e projektit	Koncept dhe Projekt
Vlera	2,368,519.38 Lekë
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 7 (O4P1_PR8)	
Titulli i Projektit	PR8: Lidhja me rrugën "Teodor II Muzaka" (Sheq i Madh, Bypass)
Konteksti i Projektit	Ndërtimi i bajpasit të Fierit është një zgjidhje shumë e mirë për të shmangur trafikun në pjesën e brendshme të qytetit por ai nuk do jetë efikas nëse nuk do të lidhet me rrjetin rrugor të bashkisë. Aktualisht bajpasi nuk është i lidhur me rrugën e Semanit, Rrugën "Teodor II Muzaka", apo Unazën "Skënderbeu" çka e bën atë jo plotësisht të aksesueshëm.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të synojë të krijojë një lidhje më funksionale dhe efikase të bajpasit të Fierit dhe qendrës së qytetit duke e lidhur atë me Unazën "Skënderbeu" me rrugën e Semanit si dhe lidhjen me Rrugën "Teodor II Muzaka". Projekti do të fokusohet në rehabilitimin e këtyre rrugëve kryesore si dhe ndërtimin e kryqëzimeve. Projekti do të jetë teknik dhe do të bazohet në të gjithë parametrat teknikë bashkëkohorë duke siguruar në këtë mënyrë zgjerimin dhe asfaltimin e rrugëve, ndriçimin e tyre, kanalizimet nëntokësore dhe pajisjen me sinjalistikë dhe trotuare.
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, komuniteti, Ministria e Transportit, Donatorë
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt do të rrisë cilësinë e jetesës së banorëve nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave publike; • Projekti do t'i shërbejë komunitetit të Bashkisë Fier por edhe qytetarëve të cilët kalojnë transit në këto zona; • Bajpasi do të jetë më tepër funksional dhe efikas.
Objektivi	Objektivi O4: <i>"Menaxhimi e zhvillimi inteligjent i tokës"</i> ; Programi P1: <i>"Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane me infrastrukturat kombëtare."</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Marrëveshje me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për asistencë teknike dhe financiare.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve • Përmirësimi i askesit ndaj bajpasit të Fierit • Lehtësim i trafikut në brendësi të qytetit
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Gjetja së investimeve që nevojiten për projektin.
Faza e projektit	Projekt
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 8 (O1P4 PR5)	
Titulli i Projektit	PR5: Ndërtimi i tregut të shumicës në shërbim të Bashkisë Fier dhe zonave pranë
Konteksti i Projektit	Bashkia e re Fier ka një potencial të madh të prodhimit të produkteve bujqësore, por tregtimi i tyre mbetet një problem i vazhdueshëm. Për këtë arsye, sot në Bashkinë e Fierit ndjehet tepër e nevojshme të ndërtohet një treg shumice në të cilin do të tregtohen prodhimet bujqësore të zonës.
Përshkrimi i Projektit	Tregu i shumicës propozohet të ndërtohet pranë bazës së tubave të Albpetrol, pra në pjesën jugore të qytetit, pranë Rugës Aulona, ndërsa projekti përfshin hartimin e projektit të objektit të tregut si dhe zbatimin e tij. Tregu synon të shërbejë si treg rajonal duke furnizuar në këtë mënyrë edhe bashkitë fqinje. Sipas projektit, tregu do të ketë ambientet e magazinimit, të shitjes si dhe të parkimit të mjeteve të transportit.
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, komuniteti, sektori privat, Fermerët, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Projekti do të shërbejë për tregtimin e produkteve bujqësore; • Projekti do të ndikojë në zhvillimin ekonomik lokal të bashkisë duke rritur fitimet dhe duke rritur numrin e të punësuarve.
Objektivi	Objektivi O1: <i>“Konkurrueshmëri përmes diversifikimit ekonomik”</i> ; Programi P4: <i>“Mbështetje, marketim, promovim dhe aftësim i biznesit lokal në funksion të zhvillimit të ekonomisë lokale.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i partneritetit Bashki- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes – Investitor; • Promovimi i projektit dhe thithja e investimeve; • Hartimi i projektit dhe nisja e punimeve.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e nivelit të zhvillimit ekonomik; • Nxitje e prodhimit bujqësor; • Përmirësimi i kushteve të tregtimit të produkteve bujqësore.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Gjetja e fondeve për financim; • Vështirësia e krijimit të partneritetit publik-privat.
Faza e projektit	Koncept
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 9 (O4P5 PR21)	
Titulli i Projektit	PR21: Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura
Konteksti i Projektit	Sot, në bashkinë e Fierit ujërat e zeza nuk trajtohen para derdhjes së tyre në rrjedhat lumore të Vjosës, Gjanicës dhe Semanit. Derdhja e tyre në këto ujëra ka ndikuar në ndotjen e tyre duke i kthyer këta lumenj në “kolektorë” të mëdhenj të ujërave të zeza, për të ndikuar më pas edhe në shëndetin e banorëve dhe cilësinë e ujërave të lumenjve.
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt do të përfshijë ndërtimin e një impianti të trajtimit të ujërave të ndotura në pjesën veriore të qytetit të Fierit, pranë pikës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve. Pavarësisht se në thelb të projektit është ndërtimi i trajtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotur, ky projekt kërkon një fazë përgatitore që përfshin shumë aktivitete dhe projekte të tjera. Një ndër to është sigurimi i rrjetit të kanalizimeve për të gjithë territorin e bashkisë si dhe lidhja e tyre me kolektorin kryesor të impiantit. Duke qenë se shumica e njësive administrative të Bashkisë Fier nuk kanë sistem të kanalizimeve të ujërave të zeza, hap i parë pra është ky. Më pas do të jetë e nevojshme të ndërtohet impianti, i cili është edhe elementi më i kushtueshëm. Rekomandohet që ujërat e nxjerra nga industritë të kenë trajtim të veçantë nga ujërat e tjera. Ky projekt do të bëjë një ndarje të ujit nga mbetjet organike për të cilat është e nevojshme të gjendet një vend depozitim.
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, Ministria e Transportit, Ministria e Mjedisit, komuniteti, sektori privat, Banka e Zhvillimit KfW
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Minimizimi i ndotjes së ujërave të lumenjve duke trajtuar ujërat e zeza para shkarkimit të tyre; • Rritje e cilësisë së jetës së qytetarëve; • Mbrojtja e mjedisit.
Objektivi	Objektivi O4: <i>“Menaxhimi e zhvillimi inteligjent i tokës”</i> ; Programi P5: <i>“Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Studimi teknik i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe mënyra se si mund të lidhet me impiantin e trajtimit të ujërave të zeza; • Studim i detajuar i parametrave biologjik dhe kimik të ujërave që derdhen në këto kanale në mënyrë që të bëhet një trajtim në përputhje me problematikat e ujit; • Studimi i ujërave industriale dhe mundësia për përfshirjen në trajtim të këtyre ujërave; • Hartimi i një plani menaxhimi i cili do të ndihmojë në mirëmbajtjen e mëvonshme të sistemit të impiantit; • Gjetja e një vend depozitimi për mbetjet e gjeneruara prej impiantit të Pastrimit.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Ndikim pozitiv mbi shëndetin publik përmes uljes së shkallës së sëmundjeve që vijnë nga ndotja e ujërave; • Mbrojtje e biodiversiteti të ekosistemeve detare dhe bregdetare; • Përmirësim të habitatit për llojet e rrezikuara; • Tolerancë e mirë ndaj ndotjeve dhe substancave toksike.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e bashkërendimit institucional për menaxhimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza; • Projekti ka nevojë për investime të shumta jo vetëm për ndërtimin e impiantit por edhe mirëmbajtjen e tij të mëvonshme; • Realizimi i projektit mund të kufizohet nga mungesa e sistemit të plotë të kanalizimit të ujërave të zeza kryesisht në territoret e ish –komunave.
Faza e projektit	Koncept
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 10 (O3P4_PR10)	
Titulli i Projektit	PR10: Mbyllja dhe rehabilitimi i pikës ekzistuese të depozitimit të mbetjeve në Fier
Konteksti i Projektit	Pika e depozitimit të mbetjeve në qytetin e Fierit ka shërbyer për 40 vite si e tillë dhe për shkak të përdorimit shumëvjeçar të tij por edhe mungesës së teknikave mjedisore të përshtatshme, ajo sot vuan nga ndotje mjedisore e madhe dhe nuk mund të përdoret më. Për pasojë lind nevoja e mbylljes së saj dhe e rehabilitimit mjedisor.
Përshkrimi i Projektit	Projekti do të përfshijë një analizë të detajuar të nivelit të ndotjes së tokave në vend-depozitim, vlerësimin e ndotjes së ajrit, ujërave nëntokësore si dhe shëndetin e banorëve. Më pas do të synohet hartimi i një plani ndërhyrjeje për pastrimin e tokës dhe kthimin e kësaj sipërfaqeje në një hapësirë të gjelbëruar. Mundësitë e planit të ndërhyrjes janë dy lloje: mund të bëhet në fillim heqja e grumbullit të mbetjeve dhe pas të gërmohet deri në 5 metër në thellësi për të hequr dheun ose të hiqet grumbulli i mbetjeve dhe pas kësaj toka të ngjishet me mjete të posaçme dhe të mbillet me bimësi për ta rikthyer hapësirën në një zonë të gjelbër. Natyrisht metoda e parë është më e kushtueshme por nëpërmjet saj arrihen rezultate më të mira.
Partnerë&Financues	Bashkia Fier, Ministria e Mjedisit, komuniteti, sektori privat
Arsyetimi i Projektit	<ul style="list-style-type: none"> • Ky projekt do të ndikojë në pastrimin e cilësisë së tokës dhe nëntokës • Hapësira e krijuar pas ndërhyrjeve do të shërbejë si një hapësirë e gjelbër për qytetin • Rehabilitimi i kësaj pike do të ndikojë ndjeshëm në shëndetin e qytetarëve
Objektivi	Objektivi O3: <i>“Mbrojtja e ripërtëritja e burimeve natyrore”</i> ; Programi P4: <i>“Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane.”</i>
Veprimet Strategjike	<ul style="list-style-type: none"> • Promovimi i projektit dhe sigurimi i fondeve; • Marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit mbi hartimin dhe realizmin e projektit; • Përcaktimi i metodës së ndërhyrjes; • Studimi i hollësishëm mjedisor mbi cilësinë e pikës aktuale të depozitimit; • Sigurimi i një vend depozitimi tjetër mbetjesh.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rritje e cilësisë së jetesës së qytetarëve; • Ulja e nivelit të ndotjes; • Mundësi e përdorimit të hapësirës së gjelbër si hapësirë publike; • Rritje e vlerës së tokave pas investimit në pikën e depozitimit; • Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.
Rreziqet	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i projektit ka nevojë për investime të shumta për shkak të procesit të komplikuar dhe të kushtueshëm të rehabilitimit; • Rehabilitimi i zonës do të ketë nevojë për përfshirjen e disa aktorëve; • Nevoja për të gjetur një pikë tjetër depozitimi; • Mundësia e krijimit të pikave alternative, informale të vend depozitimit të mbetjeve; • Procesi i rehabilitimit do të zgjasë në kohë për shkak të nivelit të lartë të ndotjes mjedisore; • Mungesa e një plani të përgjithshëm të menaxhimit të mbetjeve për bashkinë.
Faza e projektit	Koncept
Vlera	
Prioriteti	

FISHË PROJEKTI 11 (O2P1_PR1/2/3/4/5/6/7/10)	
